



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal Kaçanik  
- KUVENDI I KOMUNËS -

01 - Nr. 05-400-2193/14  
Kaçanik; 31.01.2014

Mbështetur në nenin 40.2(b) të Ligjit nr.03/L-040 - Për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 27 të Ligjit Nr.03/L-048 - Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të nenit 7 të Ligjit nr.04/L-233- Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014, të pikës 5 të Vendimit 01-Nr.05-400-24710/13.- Për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2013 dhe vlerësimet për vitet 2014-2016, si dhe nenit 61.1 lidhur me nenin 34.5 të Statutit të komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur më 31.01.2014, merr këtë:

**V E N D I M**  
**PËR BARTJEN E BILANCEVE TË PASHPENZUARA NGA TË HYRAT VETJAKE**  
**KOMUNALE TË VITIT 2012 DHE 2013, NË VITIN FISKAL 2014**

1. Me këtë Vendim miratohet bartja e mjeteve prej bilanceve të pashpenzuara nga të hyrat vetjake komunale të vitit 2012 dhe 2013, në buxhetin e vitit fiskal 2014, në shumë të përgjithshme prej 121,479.79 €.
2. Bilancet e pashpenzuara nga të hyrat vetjake komunale sipas pikës 1. të këtij Vendimi dhe pasqyrës tabelare – **Shtojca A**, do të barten në ndarjet buxhetore të vitit 2014, duke u bërë rindarja e tyre në programet – nënprogramet buxhetore dhe në kategoritë e caktuara ekonomike të shpenzimeve, ashtu siç prezantohen në tabelarin – **Shtojca B**, të cilat shtojca janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Rindarja e mjeteve të bartura nga bilancet e pashpenzuara nga viti 2012 dhe 2013, në vitin vijues fiskal 2014, me prioritet do të destinohen për realizimin e projekteve të pa përmbaruara dhe obligimeve-faturave të vonuara dhe të papaguara e të cilat barten në vitin 2014, duke mos u ndryshuar shuma dhe ndarjet e planifikuara me buxhetin e përmbyllur të vitit paraprak 2013, sipas **Shtojcës B** – Rindarja e mjeteve të bartura në vitin 2014.
4. Për realizimin e këtij vendimi, obligohet Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, e cila drejtori të njëjtin vendim do ta zbaton në Ministrinë e Financave, respektivisht në Departamentin e Buxhetit dhe Departamentin e Thesarit.
5. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës.

**Me këtë vendim njoftohen:**

1. Kyetari i komunës,
2. Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim, dhe
3. Arkiva.

